Partnerët Socialë i kanë kërkuar rregullisht qeverisë të krijojë një minimum jetik, në mënyrë që paga minimale të konsiderojë ndryshimin e rrethanave sociale dhe ekonomike si rritja e çmimeve, standardet e jetesës në rritje, dhe rritjen ekonomike e produktivitetin. Këshilli Kombëtar i Punës së fundmi arriti të dakordësohet që paga minimale në Shqipëri të rritet në 24,000 lekë (për t'u biseduar më tej me FMN). Hendeku gjinor i pagave mbetet i konsiderueshëm, pasi pagat e grave janë 18 për qind më të ulëta se pagat e burrave në zonat urbane , dhe kjo shifër sa vjen e ulet më ndjeshëm në zonat rurale.

ILO mund të ofrojë ndihmë teknike për të rritur kapacitetet kombëtare për përcaktimin e pagave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Krahas MMSR, INSTAT-i dhe Partnerët Socialë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në këtë proces.

Në lidhje me Sigurinë dhe Shëndetin në vendin e punës (SSHP), Shqipëria ka bërë një progres të dukshëm në vitet e fundit. Dy instrumente të reja të ILO-s janë ratifikuar gjatë vitit 2014, përkatësisht Konventa Nr. 167 "Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim" dhe Konventa Nr. 187 "Mbi Kornizën Promovuese për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë". Në 2016 Parlamenti ratifikoi "Konventën e Punës Detare " (Nr. 186). Përveç kësaj, Këshilli Kombëtar i Punës miratoi Dokumentin Politik të SSHP-së si dhe Planin përkatës të Veprimit 2015-2020, përgatitur me ndihmën e ILO-s në bashkëpunim me MMSR-në dhe me përfshirjen e ministrive të tjera që lidhen me këtë fushë, me institucionet publike dhe Partnerët Socialë. Zbatimi i këtij plani do të monitorohet nga Grupi i sapoformuar i Menaxhimit të Politikave të Integruara (GMPI) për Punësim, Aftësi dhe Politika Sociale, si dhe Grupet përkatëse Tematike, nën udhëheqjen e MMSR-së, për të vlerësuar progresin e bërë cdo dy vjet.

ILO ka ndihmuar Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale të përgatitë kushtet për miratimin e legjislacionit të ri në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë (SSHP) në përputhje me legjislacionin e BE-së, për përfshirjen në legjislacionin kombëtar të 17 direktivave të veçanta nga Direktiva kuadër e SSHP-së, një direktivë për Sigurinë e punëtorëve të rinj dhe 3 rregullore të tjera, në një total prej 21 aktesh ligjore të SSHP. E gjithë kjo krijon një bazë ligjore të rregullt dhe moderne për mbrojtjen e të punësuarve, duke ulur aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, përmirësimin e kushteve të punës dhe nxitjen e punës së denjë, me ndikim pozitiv në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Megjithatë, ka shumë për të bërë për përmirësimin e performancës së Shërbimeve të Inspektoriatit të Punës, përkatësisht përmes fuqizimit të aftësive të administratës në ndërmarrjen e hapave për zbatimin e planit të veprimit të SSHP, i cili do të sigurojë efikasitetin e legjislacionit të ri të hartuar. Asistenca teknike e ILO-s do të synojë t'i japë një rol më të fuqishëm dhe t'i bejë më operative komisionet për SSHP-në, duke përmirësuar ndjeshëm kështu dialogun social në nivel ndërmarrjeje. E fundit, por jo nga rëndësia, administrata e inspektimit të punës do të mbështetet edhe në punën e tyre në sektorin e bujqësisë.

1.5 Mbrojtja Sociale

Shfrytëzimi i punës së detyruar të fëmijëve është shkelje e të drejtave të njeriut. Me gjithë ndihmën e ILO-s dhe përpjekjet e aktorëve të tjerë në luftën kundër formave më të këqia të kësaj pune, raportet e fundit tregojnë vazhdimësinë e punës së fëmijëve në Shqipëri. Sipas një studimi për punën e fëmijëve, të ndërmarrë nga INSTAT-i në vitin 2012, rreth 57,000 fëmijë (ose 8 përqind e popullsisë së grupmoshës 0-15 vjeç), janë ekonomikisht aktivë në Shqipëri. Ata janë të punësuar në sektorin bujqësor (në familjet e tyre), si dhe në industri (e tekstileve, modës dhe minierave).

Një tjetër kategori e fëmijëve që punojnë janë ata të rrugës, lypësit, mbledhësit e plehrave, etj. Një studim i fundit tregon se numri i tyre është mbi 2500, pjesa më e madhe e të cilëve janë pjesë e grupit 10-17 vjeç. 74.3 përqind e këtyre fëmijëve janë romë dhe egjiptianë. Një numër i konsiderueshëm nga 0-5 vjeç shoqërojnë nënat e tyre ndërsa lypin në rrugë. (Burimi: "Studimit kombëtar mbi fëmijët e rrugës në Shqipëri", porositur nga UNICEF dhe Save the Children, Faqja 5).

Sistemi i pensioneve luan një rol qendror në sigurimin e të ardhurave për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, sistemi shqiptar i pensioneve po ballafaqohet me një sërë sfidash, që lidhen me mbulimin e ulët të sigurimeve shoqërore dhe nivelin e ulët të mbledhjes së kontributit për sigurimet shoqërore.

Për shkak të numrit të madh të njerëzve që punojnë në ekonominë informale dhe nivelit të papunësisë, numri i kontribuesve në sistemin e pensioneve ka mbetur i ulët. Shmangia e kontributeve të sigurimeve shoqërore ka qenë më e përhapur. Mospagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore do të rezultoje drejtëpërsëdrejti në një numër më të madh të popullatës me përfitime të ulta nga sigurimet shoqërore ose pa asnjë përfitim

duke rritur kështu rrezikun e varfërisë. Kjo do të kërkojë që eventualisht shteti të akordojë më shumë burime për programet e asistencës sociale.

Për t'iu përgjigjur kësaj situate, Qeveria ndërmori një sërë ndryshimesh në ligjin e Sigurimeve Shoqërore, i cili ofron për herë të parë "pensionet sociale" për ata që nuk kualifikohen për ndonjë formë pensioni sipas ligjit të Sigurimeve Shoqërore, zgjeron të drejtën e pensionit të pleqërisë për minatorët duke filluar në moshën 55 vjeçare etj. Dispozitat e reja që kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015. Veç kësaj, si pasojë e përpjekjeve të Qeverisë për të luftuar informalitetin dhe stimujt e ofruar për popullsinë rurale, mijëra njerëz i janë bashkuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore. ILO ka ndihmuar MMSR-në dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore në këtë proçes reformues me rishikimin e ndryshimeve të ligjit.

Për sa i përket përfitimit të Ndihmës Ekonomike, Administrata e Shërbimit Social Shtetëror ka forcuar edhe më tej kriteret e pjesëmarrjes në të dhe ka pastruar listat nga njerëzit që nuk duhet të përfitojnë. Veç kësaj ky përfitim i jepet nënave të familjeve si mbështetje për nevojat familjare si dhe një mënyrë për të fuqizuar gratë. Megjithatë, shumë shërbime sociale vuajnë nga mungesa e një kornize e qartë ligjore dhe buxheti i duhur si dhe janë të varura nga financimet e donatorëve dhe të shoqërisë civile.

II. Mësimet e nxjerra nga bashkëpunimet e mëparshme

Pas tre ciklesh në Shqipëri, PKPD ka vërtetuar se është një program kuadër i mirë mbi bazën e të cilit ILO të japë asistencë teknike për Qeverinë Shqiptare dhe partnerët socialë. Në dy vjet e gjysmë, ai provoi gjithashtu të jetë një instrument fleksibël, duke i dhënë një përgjigje të shpejtë dhe efikase të gjitha kërkesave drejtuar ILO-s nga Qeveria dhe partnerët socialë.

Vlerësimi i pavarur i strategjive dhe aksioneve të Programit të ILO-s për Punën e Denjë në Ballkanin Perëndimor (2012-2015) botuar në Tetor 2016 vlerësonte se qasja aprovuese ndaj bashkëpunimit për zhvillim kishte provuar të ish relativisht efektive. Pjesmarrja aktive e grave dhe aktivitetet që synonin shtrirjen e dimensionit gjinor rezultuan në një raport mbi nevojat për aftësi profesionale në Shqipëri i cili për herë të parë përfshinte edhe dimensionin gjinor. Impakt i rëndësishëm u vërejt në reformën në drejtësi dhe ndërtimin e institucioneve në Ballkanin perëndimor. Raporti nënvizonte rolin kyc të koordinatorëve kombëtarë në vendet e Ballkanit Përendimor. Rekomandimet e vlerësuesve për ILO-n në mënyrë specifike kërkonin përmirësimin e konsistencës mes planifikimit, monitorimit dhe raportimit, nevojës për të ndërtuar në mënyrë vazhdueshme strategji daljeje (post projekt) në faza më të hershme të zbatimit të projektit me qëllim rritjen e pronësisë apo përgjegjësisë kombëtare për ndërhyrjet respektive. Edhe nevoja për të forcuar përpjekjet për mobilizim fondesh është theksuar vazhdimisht në këtë raport.

PKPD provoi të jetë në koherencë të plotë me programet e agjensive të tjera të OKB-së që veprojnë në Shqipëri, duke kontribuar në mënyrë aktive në krijimin dhe zbatimin e Programit të Bashkëpunimit 2012-2016 ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe OKB-së, në kuadër kjo të Iniciativës *Një OKB*. Rëndësia dhe komplimentariteti i asistencës teknike të ILO-s është në përputhje me përpjekjet e përgjithshme të vendit për të harmonizuar kuadrin e tij ligjor, politik dhe institucional me kërkesat e pranimit në BE.

Bordi i Rishikimit të PKPD tregoi fleksibilitet dhe unanimitet duke e bërë PKPD të reagojë ndaj të gjitha kërkesave të Qeverisë e Partnerëve Socialë në kohë reale. Anëtarët dhe partnerët e ILOs kanë vlerësuar pozitivisht ciklin e menaxhimit të PKPD dhe shprehën vullnetin e tyre për të kontribuar plotësisht në ciklin e ri.

Takimet e rregullta të Bordit të Rishikimit kanë rritur përgjegjësinë e aktorëve shqiptarë. Kjo përgjegjësi dhe angazhim i qeverisë dhe partnerëve socialë për të mobilizuar mbështetjen ndërkombëtare përmes një sërë partneritetesh është një vlerë për të siguruar burimet e nevojshme për të mundësuar arritjen e rezultateve të parashikuara..

III. Prioritetet e programit për Shqipërinë

Fushat prioritare të bashkëpunimit dhe rezultatet e programit për Shqipërinë janë zhvilluar në konsultim të ngushtë me partnerët tripalësh. Procesi filloi me konsultime individuale me çdo anëtar dhe një diskutim në tryezë të rrumbullakët tripalëshe në tetor të vitit 2015. Në bazë të këtyre të dhënave fillestare, ILO përgatiti draftin e parë, për të cilin anëtarët dhanë komente dhe vërejtje me shkrim.

Procesi këshillimor mes partnerëve kombëtar tripalësh dhe ILO-s synoi që prioritetet të përqëndrohen - nga një axhendë potencialisht shumë e gjerë - në një numër të kufizuar prioritetesh dhe rezultatesh të përbashkëta të cilat mund të arrihen në mënyrë të arsyeshme në kuadrin kohor të propozuar dhe sipas burimeve të disponueshme apo të parashikueshme. Këto prioritete marrin në konsideratë avantazhin e krahasuar të ILO-s si një agjenci normative dhe trepalëshe e specializuar në Punën e Denjë. Kjo gjithashtu do të ndihmojë që ILO të përqëndrojë iniciativat e veta për mobilizim fondesh nga donatorëve potencial dhe partnerë të tjerë. Në kuadër të temës gjithëpërfshirëse të ***"Punë e Denjë për të Gjithë"*** ILO do të përqëndrohet në tri prioritete të programuara për Shqipërinë për periudhën 2016-2020. Keto janë:

1. **Nxitja e punësimit dhe e mjedisit mbështetës për ndërmarrje të qendrueshme.**
2. **Forcimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe partnerëve social për një dialog social efektiv.**
3. **Përmirësimi i mbrojtjes sociale dhe kushteve të punës**

PKPD duhet të konsiderohet si një dokument i gjallë, i hapur për rishikime të rregullta dhe rregullime në përputhje me zhvillimin e nevojave, kërkesave dhe mundësive. Plani, për këtë arësye, do të monitorohet rregullisht dhe do të rishikohet në varësi të disponueshmërisë së burimeve, nivelit të reagimit të partnerëve dhe zhvillimit të situatës ekonomike e sociale të vendit. Shtrirja dhe gama e punës së ILO-s në vend, gjithsesi, në fund të fundit varet nga mundësia e gjenerimit të burimeve shtesë nga donatorët dhe grupimi i burimeve ekzistuese me partnerë të tjerë.

Të tre prioritetet e PKPD të përcaktuara bashkarisht nga tre palët kontribuojnë në përmbushjen e Programit të Bashkëpunimit për një Zhvillim të Qendrueshëm mes Qeverisë së Shqipërisë dhe OKB në Shqipëri për periudhën 2017 - 2021. Në mënyrë specifike ato kontribuojnë në Rezultatin 3 "Programet, politikat dhe prioritetet për rritjen ekonomike janë gjithëpërfshirëse, të qendrueshme dhe me ndjeshmëri gjinore me fokus më të madh mbi konkurrueshmërinë, punën e denjë dhe zhvillimin rural", por edhe ne Rezultatin 2 "Të gjithë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë sidomos ata nga grupet vulnerabël dhe pa vëmendje, ushtrojnë të drejtën e tyre për shërbime cilësore të barabarta në respekt të të drejtave të njeriut dhe investime më efektive dhe efikase në burime njerëzore dhe financiare bëhen në nivel qendror dhe lokal për të siguruar përfshirje dhe kohezion social".

Prioriteti 1: 1. Nxitja e punësimit dhe e mjedisit mbështetës për ndërmarrje të qendrueshme

Rezultati 1.1: Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014 – 2020 e zbatuar dhe e rishikuar.

Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 shënon një moment historik për mënyrën se si projektohen politikat e zhvillimit të punësimit dhe aftësive në Shqipëri. Ishte e qartë që nga fillimi i përgatitjes së këtij dokumenti që, në mënyrë që të reformohej sistemi i formimit profesional, ishte e nevojshme një qasje me pjesëmarrje të gjerë, ku do të përfshiheshin institucionet në nivel kombëtar dhe lokal, organizatat e punëdhënësve, sindikatat, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet që përfaqësojnë interesat eshtresave të prekura nga këto politika (psh. nxënësit, prindërit si dhe praktikuesit e arsimit dhe formimit). Për këtë qëllim, përgatitja e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 është bazuar në një sërë takimesh këshillimore që filluan në mes të vitit 2012, u rifilluan në tetor 2013 dhe përfunduan në mes të vitit 2014. ILO ndihmoi Qeverinë Shqiptare dhe Partnerët Socialë me këshillim teknik dhe politik për hartimin dhe promovimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

ILO do të vazhdojë mbështetjen e saj për zbatimin e këtij dokumenti strategjik ndaj institucioneve publike (SHKP dhe AKAFPK, në veçanti) që ato të jenë më të përgatitur në përputhjen e vendeve të lira të punës dhe punëkërkuesve, si nëpërmjet menaxhimit të rasteve dhe ndjekjes së vendeve të lira.

Asistencë teknike do të ofrohet për të përshtatur kuadrin ligjor me Konventën 181 të ILO-s për Agjencitë Private të Punësimit, vendosjen e një kuadri ligjor për agjencitë e punësimit të përkohshëm, krijimin e një sistemi akreditimi, duke patur parasysh edhe dhënien/delegimin tek të tretët, nënkontraktimet dhe Direktivat e BE-së.

Më tej, ILO do të mbështesë krijimin e një mekanizmi koordinues për çështjet e punësimit ndërmjet organeve tripalëshe, ku përfshihen edhe diskutime të herëpasherëshme në mekanizmin e dialogut social. Mes institucioneve dhe Partnerëve Socialë do të ndahet një sistem informacioni i integruar për tregun e punës.

Treguesit e Rezultateve

1.1.1 Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 përditësohet në dritën e realiteteve dhe përgjegjësive të reja, si psh. procesi i pranimit në BE.
Synimi: Strategjia e përditësuar deri në fund të 2018 mbi bazën e rekomandimeve trepalëshe.

1.1.2 MMSR miraton masa korrigjuese për të rritur shtrirjen e PATP-së tek gratë dhe grupet vulnerabël të punëkërkuesve, bazuar në treguesit e performancës.
Synimi: Të paktën 50 për qind e masave korrigjuese të rekomanduara për të rritur shtrirjen e PATP-së tek gratë dhe grupet vulnerabël të punëkërkuesve miratohen deri në 2020.

.1.1.3 Kuadri rregullator për agjencitë e punës së përkohshme dhe agjencitë private të punësimit përcaktohen me dialog social dhe në përputhje me Konventën 181.
Synimi: Aktet ligjore për funksionimin e agjencive të punës së përkohshme dhe agjencive private të punësimit miratohen në vitin 2018.

Rezultati 1.2: Reformat ligjore dhe institucionale për promovimin e një mjedisi lehtësues për biznese të reja të qëndrueshme.

Një mjedis i përshtatshëm është kyç për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të qëndrueshëm. Krijimi i një mjedisi të tillë varet nga një grup i përcaktuar dhe i artikuluar mirë politikash, që mbulon ndër të tjera fushat e arsimit, mjedisit, financave, punës, tregëtisë, drejtësisë dhe të drejtat e pronës, teknologjisë e infrastrukturës. Pamundësia për ofrimin e këtij mjedisi rezulton në akses të pamjaftueshëm ndaj sipërmarrjes dhe shërbimeve për zhvillimn e biznesit, akses të kufizuar ndaj zinxhirit të vlerës më të lartë të shtuar dhe praktikave jo optimale në vendin e punës që ndikojnë në mënyrë të veçantë SME-të. Nga ana tjetër, kjo pengon rritjen e produktivitetit, çon në nivele të larta të papunësisë, të informalitetit, të varfërisë, si edhe dëmton mjediset natyrore. Udhëzuesi I ILO-s për "Mundësimin e një Mjedisi të Qëndrueshëm për Ndërmarrjet (MMQN)" është hartuar si një burim për organizatat që dëshirojnë të vlerësojnë mjedisin në të cilin rriten bizneset fillestare. Ai është hartuar që të drejtojë dhe të mbështesë këto organizata në përpjekjet e tyre për të kuptuar më mirë MMQN-në dhe për të rritur kontributin e tyre të mbështetur në përvoja të faktuara në përpjekjet për reformë të qeverisë përmes advokimit dhe dialogut. ILO i ofroi trajnime BiznesAlbania-s për këtë instrument dhe metodologjinë e tij në vitin 2012 dhe i "rifreskoi" këto trajnime edhe në vitin 2015.

Gjatë gjithë procesit të MMNQ-së, ILO do të angazhohet në mënyrë të veçantë me Biznes Albania, si organizatë përfaqësuese e punëdhënësve në Shqipëri. Mmetodologjiae MMNQ-së do të përqëndrohet në ndërtimin e kapaciteteve të organizatës për vlerësimin e fakteve dhe dialogut politik konstruktiv. BiznesAlbania do të kontribuojë me burimet e duhura njerëzore për menaxhimin e projekteve gjatë vlerësimit me MMNQ. Procesi do t'i japë vëmendje të veçantë grave të anketuara dhe grave që drejtojnë në biznese. Edhe sindikatat do të angazhohen me qëllim që të arrihet në një pronësi apo përgjegjësi dypalëshe mbi rezultatet e këtij aktiviteti.

Vlerësimi kombëtar i vështirësive kry esore të biznesit është planifikuar për vitin 2017. Vlerësimi do të përqëndrohet në formulimin e propozimeve për reforma të bazuara në fakte, promovim dhe vlerësimin e propozimeve të zbatuara. Raporti kombëtar për MMNQ-në do të përshkruajë sfidat kryesore të politikave me të cilat përballen ndërmarrjet dhe do të bëjë rekomandime për politikat për tejkalimin e tyre. Bazuar në këtë raport dhe në vijim të aktiviteteve të promovimit, është parashikuar që të nisë një dialog kombëtar mbi politikat me qëllim që të fillojnë reforma rregullatore dhe/ose institucionale.

Treguesit e Rezultateve:

1.2.1 Propozime për reforma legale, rregulluese dhe/ose institucionale do të zhvillohen dhe/ose miratohen nga qeveria bazuar në rekomandimet nga vlerësimi I MMQN.
Synimi: Minimalisht një reforme e propozuar të zhvillohet dhe/ose adoptohet deri në fund të vitit 2019.

Rezultati 1.3: Rritje e efikasitetit të politikave migratore të punës

Një pjesë e madhe e popullsisë në moshe pune në Shqipëri ka migruar jashtë shtetit dhe gjithnjë e më shume njerëz - veçanërisht të rinjtë – po kërkojnë punë jashtë Shqipërisë. Do t'i kushtohet vëmendje minimizimit

te kostove ekonomike dhe sociale të emigrimit, për të përmirësuar punësimin dhe kushtet e punës të punëtorëve jashtë dhe pët të maksimizuar impaktin e migrimit në ekonominë dhe shoqërinë Shqipëtare, duke përfshirë aftësitë për migrim, përdorimin produktiv të parave të dërguara dhe ri-integrimin në tregun e punës të migruesve të kthyer. ILO do të ndihmojë SHKP të përhapë informacionin e duhur rreth vendeve pritëse me qëllim që të lehtësojë vendimet e informuara të migrantëve të mundshëm.

ILO do të mbështesë zbatimin e Planit të Veprimit të SKPA-së dhe do të ofrojë këshillim teknik për Shërbimet e Migracionit të Punës duke krijuar mundësi për lëvizje të rregullta për punësim drejt vendeve me interes dhe duke synuar sigurimin e informacionit tw nevojshwm para-nisjes për emigrantët.

1.3.1 Të dhëna të diferencuara mbi shërbimet e ofruara në vendet pritëse.
Synimi: MMSR-ja dhe SHKP-ja hartojnë paketa informuese për këshillim për emigrantët e mundshëm.

1.3.2 Qeveria nis marrëveshje dypalëshe mbi migracionin për motive punësimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të punës.
Synimi: Marëveshjeve dypalëshe me tre shtete të iniciuara deri ne vitin 2019.

Prioriteti 2: Forcimi i kapacitetit të institucioneve shtetërore dhe Partnerëve Socialë në drejtim të dialogut efektiv social

Rezultati 2.1: Dialogu social trepalësh shtrihet në nivel rajonal përmes ngritjes së këshillave tripalësh rajonal.

Në procesin e reformës ligjore, partnerët tripalësh rishikuan kuadrin ligjor dhe institucional për dialogun social në raport me Standardet Ndërkombëtare të Punës. Si rezultat i rishikimit, janë identifikuar nevojat që mendohen të nevojshme për përmirësimin e efektivitetit dhe ndikimit të dialogut social në vend: (i) të shqyrtohet përbërja e strukturave të dialogut social në nivel kombëtar dhe rajonal, bazuar në kritere objektive të paracaktuara në konsultim me partnerët socialë në fjalë; (ii) të ngrihen këshillat rajonale konsultativë dhe të zhvillohet kapaciteti i tyre që të funksionojnë si duhet dhe të marrin pjesë efektivisht në proceset lokale vendimmarrëse mbi politikat ekonomike dhe sociale.

ILO do të mbështetë ngritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të tre këshillave konsultativë rajonalë dhe të sekretariateve të tyre teknikë në rajonet e Vlorës, Shkodrës dhe Korcës deri ne fund të 2018

Më tej, ILO do të vazhdojë të ndihmojë partnerët tripalësh në përcaktimin e një sërë kriteresh objektive dhe lehtësisht të verifikueshëm për pjesëmarrje në dialogun social tripalësh dhe dypalësh në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe në drejtim të rritjes së kapacitetit teknik të institucioneve të dialogut social nëpërmjet ekspozimit ndaj Standardeve Ndërkombëtare të Punës dhe të përvojave të suksesshme të institucioneve simotra evropiane.

Treguesit e Rezultateve

2.1.1 Tre këshilla konsultativë rajonalë krijohen dhe bëhen funksionalë.
Synimi: Tre këshilla rajonalë të punës vihen në funksionim brenda vitit 2018.

Rezultati 2.2: Sistem i përmirësuar për negociatat kolektive dhe zgjidhjen e mosmarrëshjeve të punës.

ILO do të vazhdojë të ndihmojë partnerët tripalësh në zbatimin e dispozitave të reja të miratuara të Kodit të Punës në lidhje me negociatat kolektive dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. ILO do të bazohet mbi mësimet e nxjerra nga aktorët e dialogut social në procesin e negociatave në nivel sektorial, nivel kompanie dhe në nivel kombëtar, dhe sipas kërkesës, do të: (i) lehtësojë negociatat tripalëshe mbi projekt legjislacionin për marrëveshjet kolektive, duke ofruar politika krahasimore dhe zgjidhje ligjore për çështjet e identifikuara bashkarisht nga partnerët tripalësh; (ii) ndihmojë MMSR në krijimin e një baze të dhënash të marrëveshjeve kolektive dhe për anëtarësimin e Partnerëve Socialë; (iii) ndihmojë në vlerësimin e funksionimit të Shërbimit Ndërmjetësimit në nivel kombëtar dhe rajonal dhe do të rishikojë rregulloren aktuale që ta bwjë këtë shërbim dhe rregullore plotësisht operacionale, efektive dhe efikase; (iv) ndihmojë Shërbimin e Ndërmjetësimit në krijimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit lidhur me mosmarrëveshjet e punës; (v) ndihmojë Shërbimin e Ndërmjetësimit në hartimin e programit mësimor të moduleve të trajnimit në ndërmjetësimin e punës dhe të sigurojë trajnimin e ndërmjetësuesve të punës.

Treguesit e Rezultateve[1]:

2.2.1 Plani Trepalësh i Veprimit për rritjen e efektivitetit të marrëveshjeve kolektive dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë do të miratohet dhe zbatohet.
Synimi: Plani Trepalësh i Veprimit miratohet dhe zbatohet deri në nëntor 2018.

. 2.2.2 Shërbimet e ofruara nga Shërbimi Kombëtar dhe Rajonal për Ndërmjetësim të Mosmarrëveshjeve në Punë reformohen mbi bazën e rekomandimeve të vlerësimit me qasje gjinore.
Synimi: Rekomandimet e miratuara të vlerësimit me qasje gjinore zbatohen deri në vitin 2018.

Rezultati 2.3: Përmirësim i kapaciteteve të partnerëve socialë.

PKPD do të synojë të rritë kapacitetin e Partnerëve Socialë. Në veçanti, ai do t'u mundësojë organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve që t'u japin vlerë anëtarëve të tyre përmes shërbimeve të fokusuara, të shpejta dhe të dobishme, dhe në këtë mënyrë të bëhen më të rëndësishme dhe më përfaqësuese.

Ngritja e kapaciteteve të organizatave të punëdhënësve do të fokusohet në mbështetjen e Biznes Albania që të angazhohet më efektivisht në forumet ekonomike dhe sociale në të gjitha nivelet, për të siguruar ekzistencën e një mjedisi të përshtatshëm rregullator për ndërmarrje të qëndrueshme. Një fokus kryesor i strategjisë do të jetë në përpjekjet për të forcuar kapacitetin e organizatës për t'iu përgjigjur nevojave të anëtarëve të saj në fusha të ndryshme, duke përfshirë qeverisjen e mirë, studime dhe analiza, promovim të politikave dhe lobim. Përveç kësaj, ILO do të sigurojë mbështetje për Biznes Albania për të zgjeruar bazën e anëtarësisë së saj dhe për të përmirësuar aftësinë e saj në artikulimin e shqetësimeve të punëdhënësve në media dhe në platformat politike. Asistenca teknike e ILO-s, pra, do të përqëndrohet në rritjen e kapacitetit të "organizatës së punëdhënësve" për t'iu përgjigjur nevojave e kërkesave të anëtarëve të tyre - duke i kushtuar vëmendje të veçantë anëtarëve femra - me një qasje të trefishtë, me: a) ndërtimin e kapaciteteve të brendshme, b) zhvillimin e shërbimeve të reja ose përmirësimin të atyre ekzistuese, dhe c) forcimin e kapaciteteve advokuese.

Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të punëtorëve do të përqëndrohet në zhvillimin e potencialit të sindikatave për përpunimin e strategjive dhe për të propozuar politika në favor të interesave të punëtorëve dhe në favor të qëndrimeve të përbashkëta për pjesëmarrje efikase e kontribute në debatet publike për politikat e në proceset e hartimit të politikave, që synojnë reforma dhe rregullime në sistemet e punës dhe politikës sociale në Shqipëri. Qasja do t'i japë përparësi akumulimit të njohurive dhe zhvillimit të aftësive e ekspertizës që synojnë proceset e politikave në nivel kombëtar si edhe nismat në nivel rajonal/ komuniteti/ kompanie përmes dialogut social në të gjitha nivelet. Një dimension i dytë do të adresojë nevojën për të forcuar kulturën dhe praktikën e pozicionimit dhe aktiviteteve të përbashkëta të sindikatave, si dhe ndërveprimin dhe bashkëpunimin më të ngushtë me aktorë të tjerë të interesuar të shoqërisë civile. E gjithë kjo mbështetje synon që të kuptohet më mirë roli i sindikatave dhe të ketë mbështetje publike për rëndësinë e tyre në proceset dhe strategjitë demokratike të qytetarëve. Dimensioni i tretë do të ndihmojë strukturat e sindikatave që të hartojnë strategji dhe aktivitete komunikimi, duke synuar përmirësimin e ndërveprimit dhe kanalet e përfaqësimit brenda organizatave, si dhe për të përcjellë mesazhe dhe iniciativa në shoqërinë e gjerë për një imazh më të mirë publik dhe zgjerimin e bazës së anëtarësisë, veçanërisht me të rinj e femra. Rezultatet e arritura do të rrisin efikasitetin e funksionimit që ka nisur tashmë dhe do t'i japin më shumë peshë sindikatave në dialogun social dhe në proceset e hartimit të politikave.

Treguesit e Rezultateve

2.3.1 Kapaciteti për advokim i organizatave të punëdhësve përmirësohet.
Synimi: Një kuadër politikash strategjike miratohet dhe promovohet deri në fund të vitit 2017.

2.3.2 Strukturat e qeverisjes së organizatave të punëdhënësve rishikohen për një qeverisje të përmirësuar.
Synimi: Strukturë organizative përnjë qeverisje të përmirësuar e rishikuar dhe e zbatuar deri në fund të vitit 2019.

2.3.3 Kapaciteti i organizatave të punëdhënësve për shërbime rritet.
Synimi: Të paktën një shërbim i ri prezantohet nga organzatae punëdhënësve deri në mes të vitit 2019.

2.3.4 Kapaciteti i organizatave të punëmarrësve për hartimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve rritet.

1 KSSH propozoi të bëhet një ligj i ri për kontratat kolektive. Propozimi nuk u mbështet nga BSPSH dhe MoSWY, ndaj ai nuk do të merret në konsideratë nga ky program i DWCP.

Synimi: Minimalisht një produkt analitik – rezultat i punës së përbashkët të ekspertëve, që ofron bazën e aktiviteteve/pozicioneve në nivele të ndryshme, hartohet deri ne 2018.

2.3.5 Kapacitete më të mira komunikuese që do të lehtësojnë zgjerimin e bazës së anëtarësisë duke synuar veçanërisht deficitet gjinore dhe moshore.
Synimi: Dy strategji komunikimi dhe nisma të veçanta që synojnë zgjerimin e anëtarësisë së organizatave të punëmarrësveme tw rinj duke forcuar pozicionet e grave në vendimarrjet ne organizatata e punonjësve brenda vitit 2019.

Prioriteti 3: Përmirësimi i mbrojtjes sociale dhe kushteve të punës.

Rezultati 3.1: Rritje kapaciteteve shtetërore dhe partnerëve socialë për të luftuar format më të rënda të punës së fëmijëve.

Strategjia e ILO-s në Shqipëri do të jetë mbështetje për zbatimin e Konventës për Moshën Minimale, të vitit 1973 (Nr. 138), dhe të Konventës për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve të vitit 1999 (Nr. 182) përmes ndërhyrjes në këto fusha: (i) baza e njohurive mbi punën e fëmijëve (ii) ngritje e kapaciteteve për partnerët kryesorë lidhur me çështjet e punës së fëmijëve; (ii) rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar mbi punën e fëmijëve.

Studimet mbi aksionet politike do të fokusohen tek fëmijët Romë në rrugë (sipas komenteve të Komitetit të Ekspertëve të vitit 2015), për të kuptuar përmasat e problemit në vend dhe për të paraqitur modele ndërhyrjesh që synojnë këtë grup. Do të jepet asistencë teknike për zhvillimin e kapaciteteve në institucionet kombëtare, sidomos për inspektorët e punës dhe Partnerët Socialë për të mundësuar rritje efektive dhe transferim të suksesshëm të njohurive, aftësive dhe mjeteve për çështjet që lidhen me punën e fëmijëve. Mbështetje teknike do të jepet gjithashtu për rishikimin e kuadrit ligjor kombëtar për punën e fëmijëve, në mënyrë që të ketë harmonizim me standardet ndërkombëtare të punës, dhe po kështu edhe në drejtim të rishikimit të listës së punëve të rrezikshme për fëmijët.

Treguesit e Rezultateve

3.1.1 Kuadri kombëtar ligjor për punën e fëmijëve rishikohet dhe harmonizohet me standartet ndërkombëtare të punës.
Synimi: Rishikimi i kuadrit ligjor nis brenda vitit 2020.

3.1.2 Cështjet e punës së fëmijëve janë pjesë përbërëse e planeve të punës së punëdhënësve dhe punëmarrësve
Synimi: Në 2018 planet e punës së punëdhënësve dhe punëmarrësve do të përfshijnë punën e fëmijëve.

3.1.3 Lista e punëve të rrezikshme për fëmijët Rishikohet dhe përdoret.
Synimi: Lista e rishikuar dhe në përdorim brenda vitit 2020.

Rezultati 3.2: Politikat e pagave ëpërmirësohen në përputhje me stardardet e ILO.

Paga minimale duhet të rishikohet dhe përshtatet rregullisht në bazë të Udhezimit të ILO-s dhe në zbatim të Konventave 26 dhe 131 të ILO-s mbi pagën minimale.
Politikat lidhur me pagat dhe të ardhurat janë veçanërisht të rëndësishme në kohën e krizës ekonomike. ILO ka ofruar këshillim mbi politikat, mbi mënyrat për të zbutur ndikimin e krizës globale ekonomike në Shqipëri që nga viti 2011. Me dobi do të ishte një shqyrtim tripalësh i mënyrave se si një fond garancie për pagat mund të kontribuojë në uljen e pagave të prapambetura dhe ndikimet e tyre negative sociale.

ILO do të japë mbështetje teknike për zbatimin efektiv të Konventës për Mbrojtjen e Pretendimeve të Punëtorëve (Paaftësinë Paguese të Punëdhënësve), 1992 (Nr. 173) dhe eventualisht pranimin e tij sipas ILO-s.

Treguesit e Rezultateve

1.1.1 Mekanizmi i rritjes së pagës minimale përmirësohet nëpërmjet konsensusit tripalësh.

Synimi: Mekanizmi i përmirësuar i disponueshëm brenda vitit 2020.

1.1.2 Kapaciteti i partnerëve për të ndërmarrë veprime në drejtim të pagave të barabarta për punë me vlerë të njëjtë rritet.

Synimi: Parimi i pagesës së barabartë për punë me vlerë të barabartë përfshihet në marrëveshjen trepalëshe.

1.1.3 Konventa e ILO-s (Nr. 173) për Ankesat e Punonjësve (Paaftësinë Paguese të Punëdhënësve) pasqyrohet në mënyrë efektive në legjislacionin kombëtar.

Synimi: Legjislacioni ndryshohet brenda vitit 2020.

Rezultati 3.3: Rritet efikasiteti i Inspektoriatit të Punës.

Shqipëria ka ratifikuar Konventat kryesore që lidhen me inspektimin e punës dhe forcimin e kuadrit të përgjithshëm kombëtar legjislativ për një inspektim më të mirë të punës. Vendi po kështu ka modernizuar kuadrin ligjor për Shëndetin në Punë duke vendosur në përputhje të plotë legjislacionin kombëtar me Direktivat e BE-së për SSHP-në. Në fakt, në kuadrin e projektit të zhvillimit të burimeve njerëzore të financuar së fundmi nga BE-ja , ILO ofroi mbështetje teknike në hartimin e legjislacionit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe për Strategjinë Kombëtare e Planin e Veprimit për periudhën 2015-2020.

Është ende e nevojshme që të krijohen politika dhe praktika për të bërë më efektiv zbatimin e legjislacionit, strategjinë dhe planin e veprimit, dhe për përmirësimin e dialogut social në nivel ndërmarrjeje, duke i dhënë një rol më të fuqishëm komiteteve të SSHP-së. Do të ofrohet asistencë teknike për të forcuar inspektoratin e punës në zbatimin e planit të veprimit për SSHP-në dhe të sigurojë efikasitetin e legjislacionit të ri. Në bazë të qëllimeve të përcaktuara në strategji, asistenca e ILO-s kërkohet që të: (i) rritet cilësia e vizitave të inspektimit të punës duke përdorur listat e kontrollit; (ii) zhvillohet një sistem për menaxhimin e informacionit të të gjithë legjislacionit për IP; (iii) shqyrtohet kodi i punës - për të parë mundësinë e përmirësimit të legjislacionit të punës. Është kërkuar një studim për transpozimin e direktivës së vitit 2003 të BE/88/EC (Direktiva për Orët e Punës). Gjithashtu ekziston nevoja për një rregullim të veçantë për bujqësinë.

Përveç SSHP-së, vitet e fundit i është dhënë vëmendje problemeve strukturore në arritjen e qëllimeve që lidhen me Punën e Denjë, me një theks të veçantë në punën e padeklaruar dhe për më shumë saktësi në disa sektorë ekonomikë (bujqësi dhe peshkim). Meqenëse puna e padeklaruar po bëhet një sfidë e madhe, me Partnerët Socialë është rënë dakort për disa aktivitete pilot shumë–disiplinore që mund të ndërmerren si pjesë e një strategjie kombëtare për rregullimin e punës së padeklaruar.

ILO mund të kontribuojë për të rritur kapacitetin e sistemit të inspektimit të punës (përfshirë atë të Partnerëve socialë) duke përcaktuar veprimtari strategjike për të nxitur formalizimin e ekonomisë informale dhe për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi. ILO gjithashtu mund t'i mundësojë partnerëve shqiptarë të shohin praktikat më të mira, sidomos në kuadër të BE-së, mbi miratimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive gjithëpërfshirëse për formalizimin.

Treguesit e Rezultateve

3.3.1 Strategjia e Inspektimit të Punës për punën e padeklaruar hartohet dhe zbatohet në konsultim me partnerët socialë.
Synimi : Një strategji e inspektimit të punës dhe një plan pune për punën e padeklaruar hartohet dhe zbatohet.

3.3.2 Planet e punës për inspektimin në punë përfshijnë parandalimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri për shëndetin dhe sigurinë në punë me një fokus të veçantë në promovimin e strukturave të dialogut social në vendin e punës.
Synimi : Një plan pune për inspektimin e punës së SSHP-së hartohet dhe zbatohet çdo vit.

Rezultati 3.4: Përmirësim i ndërgjegjësimit dhe njohurive të partnerëve për promovimin dhe lehtësimin e kalimit me qasje gjinore në formalizim.

ILO organizoi një konferencë rajonale për formalizimin e Ekonomisë Joformale në shtator 2015, në Mal të Zi e cila u ndoq nga një delegacion i nivelit të lartë nga Shqipëria. Strategjia e ILO-s për formalizimin e ekonomisë joformale në Shqipëri duhet të bazohet në konkluzionet e kësaj konference rajonale, që lidhen përkatësisht me zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Punës; hartimin dhe zbatimin e një qasjeje të integruar të

politikave; nxitjen dhe zgjerimin e dialogut social në ekonominë informale; si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Formalizimi i ekonomisë informale është edhe një prioritet i Qeverisë Shqiptare. Sipas Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 100,000 të punësuar janë formalizuar në harkun shtator-tetor 2015. Megjithatë, ka rëndësi që të zhvillohet një përkufizim ligjor për Ekonominë joformale në Shqipëri.

Reduktimi i informalitetit nënkupton trajtimin e problemit nga këndvështrime të ndryshme, përkatësisht një zbatim më të mirë të ligjit nëpërmjet inspektimit të përforcuar të punës, verifikimit të bazave të të dhënave dhe aplikimin e ndëshkimeve të përshtatshme sipas rastit; ri-përkufizimin dhe thjeshtimin e kuadrit rregullator; zhvillimin e stimujve për të formalizuarit duke ofruar qasje më të mirë dhe më të lehtë në sigurime shoqërore, shërbime të zhvillimit të biznesit dhe kredi; si edhe me promovimin e ndërgjegjësimit të publikut rreth përfitimeve individuale dhe kolektive të formalizimit. Objektivi afatmesëm i ILO-s do të jetë krijimi i bazës për miratimin tripalësh të politikave dhe nismave kombëtare. ILO do të kërkojë sinergji me agjencitë e OKB-së dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë për të zgjeruar shtrirjen dhe ndikimin e punës së saj.

Treguesit e Rezultateve:

3.4.1: Partnerët tripalësh identifikojnë nxitësat dhe profilin e ekonomisë informale, duke përfshirë situatat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave dhe të grupeve në nevojë.
Synimi: Diagnostifikimi kombëtar mbi ekonominë informale dakordësohet mbi baza tripalëshe deri në fund të vitit 2020.

3.4.2 Partnerët ndërmarrin një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuese për të promovuar avantazhet e ekonomisë formale.
Synimi: Brenda vitit 2019 do të nisë një fushatë kombëtare.

3.4.3: Një dokument politik me qasje gjinore lidhur me qëndrimin e sindikatave mbi ekonominë informale do të hartohet për të paktën një sektor.
Synimi: Një dokument politik me qasje gjinore mbi ekonominë informale për të paktën një sektor do të formulohet deri në fund të 2019.

IV. Masat për menaxhimin, plan zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

a) Masat për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e performancësëë, duke përfshirë rolet e partnerëve të ILO

Programi i bashkëpunimit do të menaxhohet nëpërmjet një rrjeti të përbërë nga Zyra e ILO-s EPD/ZV-Budapest, Koordinatori Kombëtar në Tiranë, Zyra Rajonale për Evropën dhe njësia teknike me seli në Gjenevë. Koordinatori Kombëtar do të luajë një rol koordinues së bashku me Zyrën e ILO-s EPD/ZV-Budapest. ILO do të vazhdojë bashkëpunimin e saj me grupet e mëdha të interesit në vend, si me OKB-në në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qendrueshëm 2017 – 2021 mes Qeverisë së Shqipërisë dhe OKB-së, dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian.

Objektivat e programit do të zbatohen së bashku (duke përfshirë mbështetje, financim dhe monitorim), nga ana e partnerëve dhe ILO-s. Nga ana e ILO-s, ky proces do të ndiqet nëpërmjet projekteve të bashkëpunimit teknik, misionet këshilluese dhe seminaret për shpërndarjen e informacionit dhe ndërtimin e kapaciteteve. Për financimin e zbatimit të këtij programi, do të përdoren burime ekstra-buxhetore dhe buxhetore të ILO-s. Partnerët dhe ILO do të vlerësojnë me kujdes burimet e nevojshme për rezultate të ndryshme dhe do të identifikojnë burimet kombëtare, burimet e ILO-s dhe nevojat për mbështetje të donatorëve. ILO do të vazhdojë të mobilizojë burime të tjera për qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura, duke pasur parasysh çështjet me përparësi të partnerëve. Qeveria dhe partnerët socialë do të venë në dispozicion personelin te specializuar përkatës dhe mjediset, dhe mbështetje logjistike, sipas rastit. Ata janë të angazhuar për zbatimin e hapave të nevojshme për të arritur rezultatet e pritura, në përputhje me planin e punës të PKPD, që është ende për t'u zhvilluar.

Zbatimi i Programit të Punës së Denjë për Shqipërinë do të rishikohet rregullisht në bashkëpunim me partnerët duke përdorur metoda interaktive. Misionet e ekspertëve të ILO-s dhe raportet e tyre të brendshme do të përdoren si pjesë e procesit të monitorimit. Dy herë në vit, ky Program do të shqyrtohet nga një Bord Rishikues

i PKPD i përbërë nga përfaqësuesit e partnerëve dhe Koordinatori Kombëtar i ILO-s. Detyra e Bordit Rishikues së PKPD është që të promovojë qëllimet e PKPD, të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e PKPD, të sigurojë pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të përfshira, dhe përmbushjen e angazhimeve të tyre për të arritur rezultatet e dakordësuara së bashku. Në fund të programit, Drejtori i EPD/ZV-Budapest do të vlerësojë arritjet e programit me partnerët vendorë. Një Plan kuadër për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve është hartuar për të mbështetur këtë vlerësim. PKPD do të ketë një vlerësim përfundimtar nëpërmjet politikave standarte të ILO-s.

b) Rreziqet

Si program kuadër që përfshin ndërhyrje dhe aktivitete të shumta, aftësia e PKPD për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet do të varet, jo vetëm në planifikimin e gjithë kuadrit, por gjithashtu në fuqinë e strategjive të menaxhimit të rrezikut individual në nivelin e projektit dhe të rezultateve.
Ndërsa kjo e fundit është përfshirë më gjerësisht ne dokumentat e projektit, e para bazohet rreth dy zonave kryesore të rreziqeve të identifikuara:

- Vullneti politik i qeverisë, duke përfshirë akordimin e mbështetjes së buxhetit kombëtar për këto rezultate
- Angazhimi i Partnerëve Socialë dhe palëve të tjera të interesuara për të punuar drejt qëllimeve të përbashkëta.

Mangësitë në financim mbizotërojnë në pjesën më të madhe të rezultateve të PKPD, për të cilat si partnerët kombëtarë ashtu edhe ILO duhet të mobilizojnë burimet e nevojshme. Këto rezultate si dhe burimet e nevoshjme janë përcaktuar duke patur parasysh mbështetjen në rënie të donatorëve. Megjithatë, mungesa e fondeve të nevojshme për PKPD mbetet një rrezik.

V. Plani i financimit

ILO, së bashku me partnerët shqiptarë do të vazhdojë të mobilizojë burime në mënyrë koherente për të operacionalizuar PKPD 2017 – 2021 për Shqipërinë. Po ashtu, ILO do të kapitalizojë mbi avantazhet e tij krahasuese dhe rrjetet e tij për të krijuar dhe promovuar partneritete mes sistemit te OKB-së, Qeverisë së Shqipërisë, partnerëve të zhvillimit dhe sektorit privat, duke konsoliduar dhe ndërtuar mbi mundësitë ekzistuese. Mobilizimi i burimeve për të adresuar mangësitë e mundshme në financim në lidhje me kuadrin e planifikuar buxhetor është një përgjegjësi e përbashkët mes ILO dhe partnerëve të saj.

Meqenëse një pjesë e konsiderueshme e burimeve të parashikuara do të përbëhet nga burime jo-të brendshme, këto do duhet të mobilizohen nga donatorë dypalësh, ose fonde në mbështetje të koherencës së OKB-së. Megjithatë, duke qenë se Shqipëria është në kategorinë e sipërme të vendeve me të ardhura të mesme dhe është vend kandidat për anëtarësimin në BE, pjesa më e madhe e mundësive bilaterale të financimit janë të mbyllura. Burimet kryesore të financimit në dispozicion për Shqipërine janë nga instrumentet e para-pranimit në BE, fondet kryesore të ILO dhe fondi “Delivering as One Fund” i cili është një fond që krijohet nga shumë donatorë për të financuar mungesa të identifikuara në Programin e Bashkëpunimit Qeveri Shqiptare dhe Kombet e Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm 2016 -2021. Ky Program promovon efektivitetin e koherencës dhe zhvillimit të Kombeve të Bashkuara.

ILO do të ofrojë mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve në kuadër të PKPD. Në varësi të raporteve vjetore të progresit në zbatimin e programit, fondet e Programit do të shpërndahen sipas vitit kalendarik. Këto fonde dhe burimet e tyre janë shqyrtuar e detajuar dhe më tej në planin e zbatimit. Plani ofron një pasqyrë të burimeve të nevojshme dhe atyre ne dispozicion, si dhe mangësive në financim. Ai gjithashtu shërben si bazë për mobilizimin e burimeve.

VI. Plani i promovimit dhe komunikimit

Zbatimi i suksesshëm i PKPD ka nevojë për komunikim efektiv. Qëllimi i aktiviteteve të promovimit dhe komunikimit është ngritja e vetëdijes ndër palët e interesuara dhe publikut të gjerë në Shqipëri mbi aktivitetet që po kryhen në kuadër të PKPD.

Aktivitetet e komunikimit dhe prezantimit synojnë kryesisht partnerët tripalësh, si dhe organizatat e

donatorëve dy dhe shumëpalësh, organizatat e shoqërisë civile dhe agjensitë e tjera ndërkombëtare dhe qeveritare që punojnë në Shqipëri në tema të njëjta apo të ngjashme. Audienca dytësore është publiku i gjerë në Shqipëri.

Aktivitetet do të programohen në mënyrë që të garantohet komunikimi dhe dukshmëria e mesazheve dhe arritjeve kyçe të programit. Këto mesazhe kyçe do të zhvillohen në bashkëpunim me partnerët tripalësh; akivitetet do të kryhen me bashkëpunimn, konsultim dhe koordinim m ta.

Planifikohet të prodhohen një numër rezultatesh të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të komunikimit dhe dukshmërisë. Këto përfshijnë ndarjen e njohurive dhe takime mësimore, si dhe fushata ndërgjegjësimi.

Rëndësia e PKPD si pjesë e kuadrit të zhvillimit të OKB-së në Shqipëri, si dhe rëndësia kyçe e politikave sociale dhe të punësimit për zhvillimin e axhendave kombëtare do të nënvizohet. Në këtë kontekst, ILO do të mbështetet gjithashtu në ndihmën e ekipit të komunikimit të OKB-së që mbeshtet agjensitë e OKB-së dhe Qeverinë e Shqipërisë për të komunikuar në mënyrë më të koordinuar dhe për të shpjeguar punën e OKB-së në Shqipëri, për të demostruar rezultatet, për të mbështetur promovimin e politikave dhe mobilizimin e burimeve dhe për ndërgjegjësimin mbi sfidat kryesore të zhvillimit. Kjo punë udhëhiqet nga strategjia e përbashkët e komunikimit të OKB-së.